

## SYLLABUS

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>FAKULTETI I FILOLOGJISË DEGA E LETËRSISË SHQIPE</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>KRITIKA LETRARE</b>
<b>Niveli:</b>	<b>BACHELOR</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>ZGJEDHORE</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>VITI I TRETË/SEMESTRI V</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E hënë/ Salla nr. 86/Ora: 13-15</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. ass. dr. Nysret Krasniqi</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>Tel: 044176095</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Kursi <i>Kritika letrare</i> përqëndrohet te hulumtimet kreative në fenomene e vepra të veçanta, duke i mbështetur ato në kuptimin e parimeve fundamentale të kritikës letrare, e cila siç dihet është njëra nga domenet kryesore të studimit të letërsisë. Gjithashtu, qëllim parësor do të jetë edhe njohja e studentëve më historinë e kritikës, format dhe metodat e saj në kontekstin e rrymave moderne të shfaqjes, si dhe njohja me autoritetet e dëshmuara të kritikës moderne shqipe që nga filltet e saj e deri në ditët e sotme.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Nëpërmjet këtij kursi studentët do të arrijnë që të forcojnë njohurinë e tyre për kritikën letrare, të hetojnë, gjykojnë dhe vlerësojnë veprat e fenomenet e ndryshme të letërsisë, si dhe ta shtojnë fuqinë e mendimit të pavarur për problemet që debatohen apo studiohen. Në vazhden e formimit profesional të tyre do të kyçen në metodat e shkollat moderne të kritikës apo interpretimit të letërsisë.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Të njihet më detajisht me kritikën letrare si njërën nga domenet kryesore të studimit të letërsisë; Të krijojë një pamje me të qartë të historisë së kritikës, formave dhe metodave të saj, shfaqjes së saj në qarqet letrare e kulturore evro-amerikane si dhe do të njohë modernitetin e saj në raport me letërsinë e përgjithshme dhe atë shqipe Të arrijë t'i aplikojë dijet dhe format më të njohura të kritikës në vepra të veçanta letrare.

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2 (90 min)	15	22.5
Ushtrime teorike/laboratorike	2 (90 min)	15	22.5
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	2.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	10	1	10
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1.5	15	22.5
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet,prezentimet ,etj	30 min	1	0.5
<b>Totali</b>			<b>127.5:25=5.1 5 ECTS</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, punë seminarike, diskutime		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi i rregullt: 5 % Detyrat dhe angazhimet e tjera: 10 % Vlerësimi i parë 20 % Vlerësimi i dytë 15 % Provimi final 50 %		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	O. Dykro, C. Todorov: <i>Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërimit</i> , 1984 I. Rugova, S. Hamiti: <i>Kritika letrare</i> , 1979		
<b>Literatura shtesë:</b>	N. Jorgaqi: <i>Antologji e mendimit estetik shqiptar</i> , 2000 I. Rugova: <i>Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983</i> , 1986		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	Kritika si shkrim diskursiv
<i>Java e dytë:</i>	Format dhe metodat e kritikës letrare
<i>Java e tretë:</i>	Zhvillimet e kritikës letrare
<i>Java e katërt:</i>	Kritika letrare shqipe
<i>Java e pestë:</i>	Vlerësim me shkrim
<i>Java e gjashtë:</i>	Sent-Bëvi: Kritika, De Sanktis: Dante Aligieri
<i>Java e shtatë:</i>	N. Fraj: Anatomia e kritikës, R. Bart: Kritikë dhe e Vërtetë
<i>Java e tetë:</i>	Vlerësim me shkrim
<i>Java e nëntë:</i>	F. Konica: Kohëtore e letrave shqipe/F. S. Noli: Don Kishoti, Hamleti
<i>Java e dhjetë:</i>	E. Koliqi: Tre poetët e mëdhenj/E. Çabej: Për gjenezën e literaturës shqipe
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	K. Maloki: Naim Frashëri, Gjergj Fishta/V. Koça: Ethem Haxhiademi, Ernest Koliqi/ M. Kuteli: Poeti Fan S. Noli
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	I. Rugova: Vepra e Bogdanit, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	S. Hamiti: Faik Konica, Lasgush Poradeci, Anton Pashku
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	R. Qosja: Porosia e madhe
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	M. Raifi: Fan S. Noli dhe Migjeni
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<i>Studenti gjatë orëve të mësimit duhet ta respektojë etikën e punës duke mbajtur qetësinë dhe duke u përfshirë në mënyrë aktive në procesin mësimor.</i>	